







© 2004 COPYRIGHT RREZEART GALICA / GIQI / ALL RIGHTS RESERVED.

# Për lirinë

*"Merr guximin të bëhesh i mençur dhe nisur."*

- Emin M. Musliu,  
*dëshmor i UÇK-së*

Albin Kurti

Demokracia në Kosovë fillon e mbaron me ditën e zgjedhjeve. Ajo është si një fëmijë që lindet i vdekur.

Demokracia lind në ato kuti votimi, por ato kuti votimi njëkohësisht janë varri i saj. Vetëm në dukje të parë. Në të vërtetë, në një sistem politik e institucional sikur yni, që mohon vullnetin e popullit dhe nuk ia mbron atij interesat, kur voton ke legjitimuar; kur s'voton ke zgjedhur. Sepse nuk je nënshtruar, sepse nuk je përshatur. Në këso zgjedhesh nuk ke zgjedhur. Zgjedhjet e këtilla janë mburojë për UNMIK-un dhe iluzion për qytetarët, ndërsa për politikanët vendas janë tendere për privatizimin e institucioneve.

Administrimi ndërkombëtar që nuk ia njeht të drejtën për vetëvendosje dhe ia mohon atë popullit në territorin që e qeveris, paraqet administrim kolonial. Qeverisja e tillë është represive. Institucionet vendase, mbi këtë bazë dhe në këtë kuadër, janë zgjatje e sundimit shtypës dhe dominimit të tij.

Njohja e vullnetit të popullit - e drejta e vetëvendosjes - është akt themeltar dhe inauguroes demokratik dhe kushti i demokracisë. Në demokraci janë të mbrujtura

vullneti (i shumicës) dhe Tjetri.

Neve na nevojitet vetëvendosje e jashtme në raport me Serbinë dhe vetëvendosje e brendshme në raport me UNMIK-un. Sepse Serbia nominalisht e ka sovranitetin mbi Kosovën; sepse mungesa e lirisë dhe demokracisë në Kosovë janë strukturuar dhe institucionalizuar.

Liria në Kosovë është çështje, sepse nuk e kemi, sepse mungon. Gjendja në Kosovë nuk është zgjedhje jona, por është rezultat i pamundësisë për të zgjedhur. Njeriu mbase mund të jetë i pasigurt se në çfarë mase zgjedhja e tij ishte njëmend e tija, por këtu në Kosovë ne jemi të sigurt se nuk po zgjedhim për jetesën tonë dhe të ardhmen tonë. Zgjedhja i paraprin vendimit. Meqenëse ne nuk zgjedhim, s'jemi gjë tjetër përveçse objekt të vendimeve të pushtetit të huaj.

Vetëvendosja paraqet vendimin tonë për vendin tonë dhe fatin e vetes sonë. Liria kolektive konsiston në të drejtën për vetëvendosje. E drejta për vetëvendosje është emri i lirisë kolektive, i lirisë për të gjithë. Neve na duhet kjo patjetër. Që të kemi shtetin tonë të pavarur dhe sovran. Që të kemi shoqëri në të cilën barazia dhe drejtësia janë vlera themelore. Për ta fituar të drejtën për vetëvendosje, duhet të fillojmë të vendosim vetë; duhet të fillojmë të sjellim vendime. Mu për shkak se nuk ekziston asnjë e drejtë, e cila është më e

politizuar sesa e drejta për vetëvendosje, ne duhet të angazhohemi maksimalisht për të. Politikisht dhe jopolitikisht.

Ne s'jemi fajtorë për mungesën e lirisë në të kaluarën, por jemi e do të jemi përgjegjës për vazhdimësinë e mungesës së saj në të ardhmen. Jemi përgjegjës edhe për ata që ende s'kanë lindur. Ne po i sakrifikojmë ata duke mos sakrifikuar vetë; ne po i rrezikojmë ata nesër duke mos rrezikuar vetë sot.

Çështja e lirisë nuk mund të shtyhet, nuk mund të vonohet. Vetë qenia njerëzore ka të bëjë me lirinë që ne s'e kemi. Durimi është degradues. S'ka nevojë të krijohen njerëz të rinj. Njerëzit e kanë lirinë nevojë të tyre. Liria s'vjen nga jashtë; liria s'instalohet. Ajo është në njerëzit dhe mes tyre.

Mund të jenë të diskutueshme përkufizimet për lirinë dhe demokracinë, por mungesa e tyre në Kosovë është e padiskutueshme. Deri kur do të na mungojnë ato? Deri sa të mungojmë ne. Nuk na ka braktisur neve liria. Ne duhet të pushojmë së braktisuri atë.

Liria na ka munguar nga herë. Duhet të jemi të gatshëm për të renë. Çka? Për atë që do të vie ngase duhet ta sjellim. Rruga e lirisë është rrugë drejt lirisë. Si? Përpara radikalisht. Dhe, radikalisht përpara. Pse? Liria dhe barazia për të gjithë janë fitorja.

## Koment

### Mbi tri ngjarjet më të rëndësishme politike të muajit maj

Shkëlzen Gashi

1. Si ngjarje e rëndësishme e muajit maj është mbledhja e Këshillit të Sigurimit e mbajtur me 27 maj 2005, ku në këtë mbledhje Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, në raportin e tij, mes tjerash, ka thënë se implementimi i standardeve është një parakusht për përparimin drejt procesit të determinimit të statusit final të Kosovës, në përputhje me rezolutën 1244. Në vijim të kësaj, duhet parë edhe mbledhjen e Grupit të Kontaktit të mbajtur në Londër, me 23 maj 2005. Po ashtu edhe dëshmia e Nicholas Burns me 17 maj para Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të SHBA-ve nuk është në shpërputhje me raportin e Annanit para Këshillit të Sigurimit dhe me konkluzionet e Grupit të Kontaktit, por as me Rezolutën 1244, ngase, përveç tjerash, në dëshminë e tij, Burns tha se zgjidhja e statusit final të Kosovës duhet t'i kontribuojë stabilitetit regional dhe integritetit evropatlantik të Ballkanit. Dihet mirëfilli se bashkësia ndërkombëtare konsideron se stabiliteti regional ruhet vetëm duke mos u ndryshuar kufijtë.

2. Një tjetër ngjarje e rëndësishme është iniciativa e PSSP-së për themelimin e Forumit Politik Gjithëpërfshirës. Edhe pse ky forum nuk do të jetë vendimmarrës, por këshilldhënës, prapëseprapë është anashkalim i votës së qytetarëve të Kosovës. Ndërkombëtarët gjithëherë na bëjnë bashkë neve. Bashkë për ta pranuar zgjidhje që do të jetë në shpërputhje me vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës. Pra, arsyeja pse pas zgjedhjeve të fundit PSSP-ja pat kërkuar që të ketë bashkëqeverisje është se kështu s'do të kishte asnjë grupacion politik që do ta kundërshtonte zgjidhjen që do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit. Rrjedhimisht, forumi krijohet që zgjidhja e ardhshme për Kosovën, që definitivisht do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit - në të kundërtën s'do të bëhej forumi fare - të mos kundërshtohet nga asnjëra parti politike. Forumi Politik Gjithëpërfshirës është bashkëqeverisja e re nënshtruese. Kjo ju levërdis politikanëve vendas sepse krejt çfarë ata duan është ta mbijetojnë politikisht zgjidhjen e padrejtë të statusit të Kosovës. Po të ishte e sigurt pavarësia, ata as nuk do ta përmendnin konsensusin.

3. Po ashtu ngjarje e një rëndësie jo të vogël është edhe akuza e PDK-së se disa ministra të Qeverisë Kosumi janë të implikuar në krim të organizuar. Kjo akuzë, siç duket, është bërë vetëm për marketing medial. Që kur kryeadministratori ka shpërfaqur idenë e Forumit Politik Gjithëpërfshirës janë heshtur akuzat. Zaten, kjo nuk është asgjë e re. Jo për shkak se dihet që politika në Kosovë është e kriminalizuar. Por, PDK-ja njëjtë ka vepruar edhe më herët. Ta zëmë, për shembull, idenë e moratoriumit. Planin e Marrëveshjes së Ohrit për Kosovën. Kornizën Kushtetuese, të cilën fillimisht e pat kundërshtuar vetëm sa për të bërë zhurmë dhe pastaj ka pranuar të futet në institucione që funksionojnë edhe sot në bazë të asaj kornize. Krejt këto PDK i bën vetëm sa për të qenë in medias res - pra në qendër të vëmendjes. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se fakti që PDK tash nuk po këmbëngul në akuzat e saj për kriminalitet është kontraproduktiv, ngase, përveç tjerash, i krijohet imunitet krimi...

Shkruaj këto parulla:

Duam punë, jo trajnime

Liri, jo standarde

1244 seriously harms you  
and others around you

1244 dëmton seriozisht shëndetin

Unë  
Nuk  
Merrem me  
Interesa të  
Kosovës

Ndalohen xhipat e bardhë  
dhe mercedesat e zi

Luftoje këtë pushtet!

Vendi ynë, vendimi ynë

Vetëvendosje!

UNMIK's Alternatives Alter Natives

Rrjeti i Aksionit për Kosovën (Kosova Action Network - KAN) është lëvizje qytetare, e cila synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. KAN angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

**ICAN**  
kosovactionnetwork

Rrjeti i Aksionit Për Kosovën  
Kosova Action Network

Kroi i Bardhë, nr. 76  
Lagja Dardania  
Prishtinë, Kosovë

038 541411  
vetevendosje@hotmail.com  
vetevendosje@yahoo.com  
vetevendosje@gmail.com  
www.kan-ks.org

**KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!**

Graphic & design: Rrezeart Galica - Gijq

## Sovraniteti

1. Me gjithë angazhimin e vreshtarëve dhe verëtarëve kosovarë për të rritur kapacitetet prodhuese dhe kualitetin e prodhimeve finale, fakti që Kosova nuk ka sovranitet, po ju pamundëson atyre plasimin e verërave në tregun e jashtëm...

2. Kosova i paguan Monacos 20 - 30 milion € në vit për huazimin e prefiksit ndërkombëtar për telefoni mobile. Kurse, për telefoninë fikse shkojnë gati po aq milion € në buxhetin e Serbisë...

3. Filmi kosovar me regji të Isa Qoses, e skenar të Mehmet Krajës është refuzuar nga Festivali i Filmit në Cannes.

Menaxherit të Kosovafilmit i është thënë se filmi mund të paraqitet vetëm nën ombrellën e Unionit Serbi Mali i Zi...

4. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i Republikës së Shqipërisë, Blendi Klosi, e ka hapur takimin e ministrave të kulturës të vendeve të Evropës Juglindore, të mbajtur në fund të muajit mars të këtij viti, në Kopenhagë, dhe në atë takim nuk ka qenë e ftuar Ministria e Kulturës e Qeverisë së Kosovës.

Blendi Klosi nuk e ka ftuar as Ministrinë e Kulturës të Malit të Zi. As të Serbisë. E ka ftuar Ministrinë e Kulturës të Unionit Serbi Mali i Zi...

5. Më 25 shkurt 2005 në Shkup është mbajtur një konferencë lidhur me sistemin e sigurisë kufitare të vendeve të Ballkanit Perëndimor që janë njëkohësisht edhe pjesëmarrëse të Procesit të Stabilizim Asocimit. Atje janë takuar Ministrat e Brendshëm të Maqedonisë, Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Serbisë e Malit të Zi dhe Kroacisë dhe kanë firmosur një deklaratë për bashkëpunim të mëtutjeshëm ndërkufitar. E Kosova?! Kosova ka qenë e përfaqësuar nga Unioni Serbi Mali i Zi.

(Vijon në numrin e ardhshëm)